




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHKOLLA E MAGJISTRATURËS



MINISTRIA E DREJTËSISË



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

DHE

MINISTRISË SË DREJTËSISË

PËR

REALIZIMIN E VEPRIMTARISË SË FORMIMIT PROFESIONAL TË

PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE

Tiranë, Nëntor 2015

Preambul

Shkolla e Magjistraturës dhe Ministria e Drejtësisë në vijim të quajtura *Palë*:

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të sistemit të drejtësisë në kuadër të forcimit të shtetit të së drejtës dhe demokracisë;

Dukë marrë në konsideratë politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra për funksionimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm;

Duke konfirmuar angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta në veprimtarinë dhe etikën e të gjitha hallkave të sistemit gjyqësor;

Duke konsideruar se një ndër objektivat kyç në ushtrimin e veprimtarisë së sistemit gjyqësor është efikasiteti dhe efica e administratës gjyqësore në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira vendase dhe ato evropiane;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të këtij memorandumi për të përmbushur edhe angazhimet në kuadër të Integritimit Evropian të vendit;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale: në ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi, në vijim i quajtur *Memorandumi*.

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij memorandumi është nxitja e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive të formimit profesional të punonjësve të administratës gjyqësore për të përmirësuar dhe garantuar aftësitë profesionale të tyre.

2. Nëpërmjet këtij memorandumi synohet:

- forcimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të administratës gjyqësore;
- përmirësimi i veprimtarisë së punonjësve të administratës gjyqësore për ofrimin e shërbimeve në kohë dhe cilësi;
- sigurimi i angazhimit profesional dhe etik të punonjësve të administratës gjyqësore.

Neni 2

Objekti i bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për hartimin dhe implementimin e programeve të posaçme për kryerjen e veprimtarive të formimit profesional për punonjësit e administratës gjyqësore gjatë periudhës 2015 - 2018, sipas roleve dhe përgjegjësi të parashikuara në këtë memorandum.

Neni 3

Roli dhe përgjegjësitë e Palëve

1. Bashkëpunimi sipas këtij memorandumi realizohet si vijon:

a) Ministria e Drejtësisë:

i) propozon listën e aktiviteteve që do të përfshihen në veprimtarinë e formimit profesional të punonjësve të administratës, në përputhje me nevojat dhe funksionet që ata kryejnë. Për gjetjen dhe adresimin e tematikave të trajnimit, Ministria e Drejtësisë konsultohet me kryetarët e Gjykatave dhe me institucionet vendase dhe të huaja që ofrojnë informacione dhe njohuri për fusha specifike;

ii) harton listën e punonjësve të administratës gjyqësore që do të marrin pjesë në aktivitetet e formimit profesional, në bashkëpunim me Kryetarët e gjykatave;



iii) cakton një person kontakti në cilësinë e koordinatorit, i cili do të kujdeset për mbarëvajtjen e zhvillimit të aktiviteteve të formimit profesional .

iv) përcakton formatin e regjistrimit të të dhënave lidhur me frekuentimin dhe tematikën e aktiviteteve të formimit profesional;

b) Shkolla e Magjistraturës:

i) përcakton listën e aktiviteteve që do të përfshihen në programin e formimit profesional të punonjësve të administratës;

ii) siguron teknikat dhe metodologjinë e zhvillimit të programit të formimit profesional të punonjësve të administratës gjyqësore;

iii) harton listën dhe mundëson pjesëmarrjen e ekspertëve për çdo aktivitet të formimit profesional dhe bashkëpunon me ta lidhur me metodologjinë e ekspertizës që do të ofrohet;

iv) organizon sesionet trajnuese për trajnerët;

v) përcakton kalendarin e aktiviteteve të formimit profesional të punonjësve të administratës gjyqësore dhe e vendos atë në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë dhe gjykatave;

2. Palët marrin përsipër të kryejnë bashkarisht:

a) caktimin e modeleve për çertifikimin e pjesëmarrësve;

b) hartimin e pyetësorëve të vlerësimit të aktiviteteve trajnuese;

c) sigurimin e mjeteve teknike të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional.

Neni 4

Forma e bashkëpunimit

1. Për efekt të efincës në kohë dhe kosto, njoftimi i pjesëmarrësve dhe çdo komunikim tjetër, do të kryhet nëpërmjet postës elektronike dhe kur është e mundur në adresat zyrtare.

2. Shkolla e Magjistraturës njofton nëpërmjet Sekretarisë Shkencore së Programit të Formimit Vazhdues Koordinatorin e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me aktivitetet e formimit profesional dhe modalitetet e zhvillimit të tyre, jo më vonë se 15 ditë nga data e aktivitetit.

3. Koordinatorin e Ministrisë së Drejtësisë mban kontakte me Sekretarinë Shkencore të Programit të Formimit Vazhdues lidhur me:

a) listat e pjesëmarrësve në aktivitetet e formimit profesional;

b) njoftimet mbi mosparaqitjen e pjesëmarrësve në aktivitetet e formimit profesional;

c) çdo informacion që lidhet me zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional.



4. Koordinator i përcjell pranë Sekretarinë Shkencore të Programit të Formimit Vazhdues konfirmimet e pjesëmarrësve dhe ndarjen e tyre në grupe sipas tematikave/kurseve përkatëse, jo më vonë se 5 ditë nga data e caktuar për zhvillimin e aktivitetit.

Neni 5

Regjistri i pjesëmarrjes

1. Regjistri i pjesëmarrjes plotësohet nga Sekretaria Shkencore të Programit të Formimit Vazhdues në prani të Koordinatorit të Ministrisë së Drejtësisë në bazë të listë prezencave të firmosura nga çdo pjesëmarrës, në fund të aktivitetit trajnues.
2. Listë prezencave e çdo aktiviteti përpilohet në dy kopje. Një kopje i dorëzohet Koordinatorit të Ministrisë së Drejtësisë dhe një kopje mbahet nga Sekretaria Shkencore e Programit të Formimit Vazhdues.

Neni 6

Çertifikimi i pjesëmarrësve

1. Pajisen me çertifikatë vetëm pjesëmarrësit që kanë ndjekur në mënyrë të plotë të gjithë aktivitetin e planifikuar.
2. Çertifikimi i pjesëmarrësve kryhet me nënshkrimin e Palëve.
3. Pjesëmarrësit që kanë frekuentuar pjesërisht aktivitetin e planifikuar, pajisen me vërtetim pjesëmarrjeje ku shënohet tema dhe ditët me sesionet e frekuentuara.
4. Çertifikatat i dorëzohen koordinatorit të Ministrisë së Drejtësisë, i cili kujdeset për shpërndarjen e tyre.

Neni 7

Llojet e aktiviteteve të formimit profesional

Llojet e aktiviteteve të formimit profesional në të cilat do të bashkëpunohet janë:

1. Seminare;
2. Tryeza të rrumbullakta;
3. Grupe të përbashkëta pune për studimin e projekteve.



Neni 8

Vlerësimi i zbatimit të memorandumit

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkarisht zbatimin e memorandumit nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti akademik.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara gjatë një viti akademik edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara. Raporti publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

Neni 9

Komunikimi mes palëve

1. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 10

Kostot financiare

1. Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion.

Neni 11

Ndryshimi i Memorandumit

1. Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.



Neni 12

Kohëzgjatja e Memorandumit

Ky memoranduum zbatohet për periudhën Nëntor 2015 - Korrik 2018, deri në përfundimin e vitit akademik.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 14


Hyrja në Fuqi

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Shkollën e Magjistraturës dhe dy në Ministrinë Drejtësisë.

Nënshkruar në Tiranë, në 10.11. 2015.

Shkolla e Magjistraturës


Prof. Asoc. Dr. Sokol Sadushi

DREJTOR
TIRANË

Ministria e Drejtësisë


Nasip Naço

MINISTËR I DREJTËSISË